



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2020:035468

Datë: 11.02.2025

Numri i dokumentit: 06833259

PKR.nr.389/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti për Krime të Rënda, Kryetari i trupit gjykues-Gjyqtari Xhemajl JUSUFI, anëtarët e trupit gjykues - Gjyqtarët Fatos SEJDIJAJ dhe Marigona LAJQI, me bashkëpunëtoren profesionale Arbenita DËRGUTI, në çështjen penale ndaj të akuzuarit F.V., për shkak të veprës penale – Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 paragrafi 1 të Kodit Nr.06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (*tutje si: KPRK*), duke vendosur sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda PP.nr.228/2019, të datës 02.11.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor të datës 09.01.2025, në prezencën e palëve Prokurorit të Shtetit Fetije Bajrami, të akuzuarit F.V. dhe mbrojtësit të tij sipas detyrës zyrtare Avokat Avdi Dinaj, me datë 13.01.2025 ka shpallur publikisht, ndërsa më datë 11.02.2025 ka përpiluar me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

F.V., nga i ati Z., e ëma B., e vajzërisë M., i lindur me datë ....., në Mitrovicë, ku edhe tani jeton Rr: “U.K.”, pa. nr., me numër personal ....., Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor, i martuar, baba i dy (2) fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Me datë 01.08.2019, në Mitrovicë, pa autorizim ka poseduar me qëllim shitjeje substanca narkotike të shpallura me ligj si narkotik, ashtu që fillimisht tek i njëjti, përderisa ka qenë në lokalin “V.” i janë gjetur sasia prej 1.43 gram marihuanë, e pastaj gjatë kontrollit të shtëpisë janë

sekuestruar sasia prej 0.95 gram, sasia prej 1.87 gram, sasia prej 1.00 gram, sasia prej 0.40 gram, sasia prej 0.58 gram dhe sasia prej 0.05 gram, në peshë të përgjithshme prej 6.28 gram si dhe peshorja digjitale e cila ishte fshehur nga nëna e tij, e të cilat nga pjesëtar të DHTN-së janë konfiskuar, e që nga ekspertiza ka rezultuar se përmban kanabis marihuan Tetrahidrokanabinol (THC), ndërkaq në peshore digjitale ka rezultuar se përmban kanabis marihan Tetrahidrokanabinol (THC).

Me këtë ka kryer veprën penale: Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 paragrafi 1 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata në mbështetje të nenit 1, 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 69, 70, 71, 72 dhe nenit 267 paragrafi 1 të KPRK-së, lidhur me nenin 276, 359, 360, 364, 449, 450 dhe 452 të KPP-së të akuzuarin e:

#### G J Y K O N

- I. Dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.
- II. Dënim me gjobë në shumë prej 800.00 (*me fjalë: tetëqind*) euro, të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 30 (*tridhjetë*) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi. Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, Gjykata do të veprojë në bazë të nenit 43 të KPRK-së, ashtu që dënimin me gjobë do t'ia zëvendësoj me dënim me burg, ku një (1) ditë burgim do t'i llogaritet me 20 (njëzetë) euro gjobë të papaguar.
- III. Në mbështetje të nenit 267 paragrafi 5 të KPRK-së, e lidhur me nenin 276 paragrafi 2 nën paragrafi 2.4 të KPP-së, Urdhërohet konfiskimi i përhershëm i substancës narkotike-të llojit kanabis (marihuanë), e cila përmban tetrahidrokanabinol (THC), me peshë neto të përgjithshme 6.28 gram dhe Urdhërohet Policia e Kosovës që të njëjtën ta shkatërrojë, sipas procedurave ligjore në fuqi, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.
- IV. Obligohet i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej tridhjetë (30) euro si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit të paguajë shumën prej pesëdhjetë euro (50), të

gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

V. Palë të dëmtuar sipas aktakuzës, nuk kishte.

### A r s y e t i m

#### *Rrjedha e procedurës:*

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzën PP.nr.228/2019, të datës 02.11.2020, kundër ndër të tjerë, edhe të akuzuarit F.V., për shkak të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267, paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 09.01.2025, në të cilën kanë qenë të pranishëm Prokurori i shtetit i Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda Fetije Bajrami, i akuzuari F.V. dhe mbrojtësi i tij avokat Avdi Dinaj, sipas detyrës zyrtare. Në shqyrtim gjyqësor, i pandehuri është deklaruar i pafajshëm për veprën penale që i vihej në barrë, ndërsa gjykata ka administruar provat materiale dhe është dhënë fjala përfundimtare e palëve.

#### *Fjala përfundimtare e palëve:*

Prokurori i Shtetit Fetije Bajrami, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: mbetet në tërësi pranë aktakuzës së ushtruar ndaj të pandehurit F.V. për veprën penale e cila i vihet në barrë nga neni 267 paragrafi 1 të KPRK-së, e që i njëjti ka kryer veprën penale është vërtetuar gjatë shqyrtimit gjyqësorë dhe atë pas administrimit të provave, që në mënyrë të padyshtimë provohet se i pandehuri F.V. ka poseduar substancat narkotike me qëllim të shitjes gjë që kjo shihet edhe nga fakti se substancat narkotike i ka ndarë në qese të vogla me qëllim të shitjes, e po ashtu pas kontrollit të shtëpisë dhe lokalit ku ka punuar i pandehuri janë sekuestruar substancat narkotike që pas marrjes së ekspertizës ka rezultuar në peshe 9.25.001 gram, ndërsa në dëshminë 1.10 pas ekzaminimit ka treguar se është prezent kanabisi që përmban tetrahidrokanabinol dhe kokainë, po ashtu në shtëpinë e të pandehurit është konfiskuar edhe peshorja digjitale që është dëshmia D10 e cila pas ekzaminimit në peshore është gjetur prezent kanabisi-marihuana që ka përmbajtur edhe kokainë, duke marrë parasysh fotodokumentacionin që gjendet në shkresat e lëndës ku shihen narkotikët e sekuestruar në shtëpinë e të pandehurit, vërtetimet të lëshuara nga ana e

policisë pas konfiskimit të narkotikëve vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale me qëllim shitje të narkotikëve, andaj i ka propozuar gjykatës që me rastin e shqiptimit të dënimit të merr parasysh rrethanat rënduese dhe atë peshën e veprës penale që është mjaft e rëndë sepse i pandehuri kishte përgatitë për shitje substancat narkotike me qëllim shitje, e që me realizimin e shitjes së këtyre substancave do të përfshiheshin edhe qytetarët tjerë, pastaj dashjen e të pandehurit për të kryer veprën penale duke i ndarë veç e veç substancat narkotike me qëllim shitje, dhe i ka propozuar gjykatës që të pandehurin ta shpallë fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit.

Mbrojtësi i të akuzuarit F.V., avokat Avdi Dinaj, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: nga provat e administruara në këtë çështje penale është vërtetuar sasia e narkotikut e cila është gjetur tek i pandehuri, mirëpo me asnjë provë nuk vërtetohet se ky narkotik ka qenë i dedikuar për shitje për faktin se i pandehuri është konsumues i rregullt i narkotikut, andaj ndarja e marihuanës në sasi të vogla për konsumim nuk do të thotë se i njëjti ka qenë i dedikuar për shitje, andaj në këtë aspekt konsideroj se përmbushen elementet e veprës penale nga paragrafi 1 i nenit 269 apo eventualisht nga paragrafi 2 i nenit 268 të KPRK-së, për çka i propozoj gjykatës që ta bëjë ri cilësimin juridik të veprës penale ndërsa me rastin e shqiptimit të dënimit të ketë parasysh faktin se nga koha e kryerjes së veprës penale kanë kaluar rreth 5 vite, nuk ka provë se më parë është i gjykuar ndaj tij nuk zbatohet procedurë për ndonjë vepër tjetër penale, është babai dy fëmijëve të mitur, duke konsideruar se edhe më një dënim të zbutur do të arrihet qëllimi i dënimit.

I akuzuari F.V., ka deklaruar se, e mbështet fjalën e mbrojtësit të tij dhe nuk kam çfarë të shtoj.

*Provat e administruara:*

Gjykata, gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike ka administruar provat materiale si në vijim :

- Raporti i Ekspertimit të substancave narkotike me numër të referues AKF-2019-2352/2019-2081 i datës 02.10.2019 lëshuar nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë në Prishtinë;
- Raporti i hetuesit Mehmet Tërbunja, i datës 01.08.2019;
- Shënim zyrtar nga hetuesi Avdyl Bajrami, i datës 01.08.2019;
- Raporti i hetuesit Nuhi Fejza, i datës 01.08.2019;
- Urdhri për aprovim retroaktiv UGJK.nr.49/19, datës 02.08.2019;
- Procesverbal mbi bastisjen e banesës dhe personave, i datës 01.08.2019;
- Raporti i këqyrje së vendit të ngjarjes, i datës 01.08.2019;

- Lista e gjërave të konfiskuara nga F.V., e datës 01.08.2019;
- Lista e gjërave të konfiskuara nga B.V.e datës 01.08.2019, dhe fotodokumentacioni.

Pas administrimit të provave materiale, i pandehuri nuk ka dhënë mbrojtjen e tij, respektivisht ka shfrytëzuar të drejtën e mbrojtjes në heshtje dhe ka mbetur pranë deklaratës së dhënë në polici me 05.08.2019, ku mes tjerash kishte deklaruar se, me datë 01.08.2019 ka qenë në lokalin “V.” së bashku me E.S., sa i përket substancës narkotike e cila i është gjetur në shtëpinë e tij, ka theksuar se të njëjtën e mban për ta konsumuar sepse e përdor kohë pas kohe, ndërkaq substanca narkotike e cila është gjetur te nëna e tij dhe peshorja digjitale, ka deklaruar se i përkasin atij, por që nëna e tij nga frika i ka parë dhe i ka marrë të njëjtat.

#### *Vlerësimi i gjykatës:*

Gjykata, pas vlerësimit të pretendimeve të palëve dhe administrimit të provave materiale të lartë cekura, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku në përputhje me nenin 360 të KPP-së, ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ashtu që bazuar në një gjendje të tillë të vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë të kësaj çështje penale, kjo gjykatë vlerëson se i akuzuari F.V. ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet sipas aktakuzës.

Nuk është kontestuese se me datën 01.08.2019, përderisa i akuzuari ka qenë në lokalin “V.”, dhe pas një kontrolli që është bërë nga ana e Policisë së Kosovës, i janë gjetur sasia prej prej 1.43 gram marihuanë, e pastaj gjatë kontrollit të shtëpisë janë sekuestruar sasia prej 0.95 gram, sasia prej 1.87 gram, sasia prej 1.00 gram, sasia prej 0.40 gram, sasia prej 0.58 gram dhe sasia prej 0.05 gram, në peshë të përgjithshme prej 6.28 gram si dhe peshorja digjitale e cila ishte fshehur nga nëna e tij.

Këto fakte, përveç që nuk janë kontestuar nga i akuzuari, vërtetohen edhe nga provat e administruara, respektivisht nga provat materiale.

Gjykata vëren se prokuroria në aktakuzën e saj pretendon se i akuzuari F.V. pa autorizim ka poseduar me qëllim shitjeje substanca narkotike të shpallura me Ligj si narkotik ashtu që fillimisht tek i njëjti përderisa ka qenë në lokalin “V.” i janë gjetur sasia prej 1.43 gram marihuanë, e pastaj gjatë kontrollit të shtëpisë janë sekuestruar sasia prej 0.95 gram, sasia prej 1.87 gram, sasia prej 1.00 gram, sasia prej 0.40 gram, sasia prej 0.58 gram dhe sasia prej 0.05 gram, në peshë të përgjithshme prej 6.28 gram, peshorja digjitale e cila ishte fshehur nga nëna e

tij, e të cilat nga pjesëtar të DHTN-së janë konfiskuar, e që nga ekspertiza ka rezultuar se përmban kanabis marihuan Tetrahidrokanabinol (THC), ndërkaq në peshore digjitale ka rezultuar se përmban kanabis marihan Tetrahidrokanabinol (THC).

Nga raporti i ekspertizës së Agjencisë së Kosovës për Forenzikë-AKF me numër Referues AKF-2019-2352/2019-2081 i datës 02.10.2019, vërtetohet se ekzaminimi i substancës bimore me ngjyrë të gjelbër/kafe ka treguar se është prezent Kanabisi (marihuana) që përmban Tetrahidrokanabinol (THC), gjithashtu është vërtetuar se ekzaminimi i mbetjes së substancës bimore me ngjyrë të gjelbër/kafe nga Dëshmia #10 (peshorja e gjetur në shtëpinë e të akuzuarit), përmban kanabis (Marihuanë) që përmban gjurmë të Tetrahidrokanabinolit (THC) dhe Kokainë.

Nga shënim zyrtar nga hetuesi Avdyl Bajrami, i datës 01.08.2019, vërtetohet se nga zyrtarët e DHTN-së në Mitrovicë, gjatë bastisjes në lokalit dhe shtëpisë tek i akuzuari F.V., janë gjetur dhe konfiskuar D#4- sasi e dyshuar e marihuanës me peshë rreth 1.88 gram, D#5- sasi e dyshuar e marihuanës me peshë rreth 0.95 gram, D#6- sasi e dyshuar e marihuanës me peshë rreth 1.92 gram, D#7- sasi e dyshuar e marihuanës me peshë rreth 1.24 gram, D#8- sasi e dyshuar e marihuanës me peshë rreth 0.42 gram, D#11- sasi e dyshuar e marihuanës me peshë rreth 0.96 gram, D#12- sasi e dyshuar e marihuanës me peshë rreth 0.03 gram, ndërsa gjatë bastisjes edhe nga e dyshuara B.V, nëna e të dyshuarit F.V. gjatë bastisjes në trup i janë gjetur D#9- sasi e dyshuar e marihuanës me peshë rreth 1.52 gram dhe një peshore digjitale.

Nga Urdhri për aprovim retroaktiv UGJK.nr.49/19, datës 02.08.2019, vërtetohet se është aprovuar Urdhri gojor gjatë kontrollit të lokalit “T.V.” dhe shtëpisë së bashku me objekte përcjellëse të dyshuarit F.V., e cila gjendet në Rr. “Ukshin Kovaçica” në Mitrovicë.

Nga procesverbali mbi bastisjen e banesës dhe personave, i datës 01.08.2019, vërtetohet se nga Policia e Kosovës-Njësia për Hetimin e Trafikimit me Narkotikë në Mitrovicë-Jugu, me datën 01.08.2019, në Rrugën “Ukshin Kovaçica” në Mitrovicë, me lejen e pronarit të shtëpisë F.V., njësitë policore kanë hyrë brenda dhe gjatë bastisjes së lokalit dhe shtëpisë së të akuzuarit F.V., janë gjetur dhe konfiskuar sendet si më lartë.

Nga raporti i këqyrje së vendit të ngjarjes, i datës 01.08.2019, vërtetohet se Policia e Kosovës-Njësia e DHTN-së, kanë shkuar në vendin e ngjarjes dhe gjatë kontrollit të lokalit, shtëpisë dhe

objekteve përcjellëse të shtëpisë kanë hasur në substanca narkotike të dyshimta, dhe po ashtu në trupin e një të moshuare është gjetur një qese me substancë e dyshimtë dhe një peshore.

Nga lista e gjërave të konfiskuara nga F.V., e datës 01.08.2019, vërtetohet se janë gjetur dhe konfiskuar sasi e dyshuar e marihuanës me peshë (të përgjithshme) prej 6.28 gram, të ndara në shtatë pjesë.

Nga lista e gjërave të konfiskuara nga B.V., e datës 01.08.2019, vërtetohet se janë gjetur dhe konfiskuar sasi e dyshuar e marihuanës me peshë rreth 1.52 gram, dhe një peshore digjitale.

Nga vështrimi në foto dokumentacionin që gjendet në shkresat e lëndës, rezulton se këto substanca të dyshuara janë gjetur në lokalin dhe shtëpinë e të akuzuarit F.V..

Nga të gjitha këto, Gjykata vlerëson se në veprimet e të akuzuarit F.V., përmbushen të gjitha elementet e veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 paragrafi 1 të KPRK-së, për të cilën veprë është paraparë *dënim me gjobë dhe me burgim prej dy (2) deri në tetë (8) vjet*.

Sipas dispozitës ligjore nga neni 267 paragrafi 1 të KPRK-së, veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, për të cilën akuzohet i akuzuari sipas aktakuzës e kryen : *“Kushdo që pa autorizim blen ose posedon me qëllim të shitjes apo shpërndarjes, ose ofron për shitje substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, substanca psikotrope apo substanca analoge”*.

Gjykata, dashjen e të akuzuarit se i njëjti ka pasur për qëllim që narkotikun në fjalë të shesë, e ka nxjerrë nga rrethanat faktike të rastit, për faktin se të njëjtit në lokalin “T.V.” gjatë kontrollit nga Policia e Kosovës si dhe në shtëpinë e tij, i janë gjetur 1.43 gram marihuanë, e pastaj gjatë kontrollit të shtëpisë janë sekuestruar sasia prej 0.95 gram, sasia prej 1.87 gram, sasia prej 1.00 gram, sasia prej 0.40 gram, sasia prej 0.58 gram dhe sasia prej 0.05 gram, në peshë të përgjithshme prej 6.28 gram, peshorja digjitale e cila ishte fshehur nga nëna e tij, e të cilat nga pjesëtar të DHTN-së janë konfiskuar. Pra fakti se i akuzuari ka poseduar substancën narkotike të përshkruar si dispozitiv të këtij aktgjykimi, të ndara në qese të vogla, në peshë të përgjithshme prej 6.28 gram si dhe peshorja digjitale të cilën nëna e të pandehurit ishte munduar të fshehte, sipas vlerësimit të gjykatës, vërteton faktin se qëllimi apo dashja e të akuzuarit ka qenë që substancën narkotike ta shesë përndryshe do të ishte e palogjikshme ndarja në sasi të ndara si dhe

peshorja digjitale nga e cila sipas raportit të AKF-së numër Referues AKF-2019-2352/2019-2081 i datës 02.10.2019, evidentuar si Dëshmia #10 (peshorja e gjetur në shtëpinë e të akuzuarit), përmban kanabis (Marihuanë) që përmban gjurmë të Tetrahidokanabinolit (THC) dhe Kokainë.

Gjykata po ashtu vlerësoi pretendimet e mbrojtjes, se substancën narkotike të cilën e kanë gjetur dhe sekuestruar policia nga i akuzuari, e ka pasur për përdorim personal dhe se në veprimet e të akuzuarit përmbushën elementet e veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 të KPRK-së apo veprës penale nga neni 268 paragrafi 2 të KPRK-së. Gjykata vlerëson se ky pretendim i mbrojtjes është i paqëndrueshëm për faktin se Policia e Kosovës ka gjetur dhe konfiskuar substancë narkotike të llojit marihuanë me peshë totale prej 6.28 gram dhe të ndara në shtatë pjesë, një peshore digjitale të cilën nëna e të pandehurit ishte munduar që ta fshehte, të gjitha këto vërtetojnë faktin se qëllimi apo dashja e të akuzuarit ka qenë që substancën narkotike ta shes, përndryshe, Gjykata vlerëson se do të ishte e palogjikshme ndarja e substancës narkotike si dhe mbajtja e peshores digjitale në të cilën është konstatuar se ka gjurmë të tetrahidokanabinolit (THC) dhe kokainë, nëse i pandehuri do të kishte qëllim vetëm konsumimin e narkotikut të gjendur te ai.

Gjykata vlerëson se të gjitha provat vërtetojnë faktin se i akuzuari ka pasur në posedim këtë sasi të narkotikëve me qëllim të shitjes, kjo pasi nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar pa mëdyshje, se pas kontrollit të bërë në shtëpinë pronar i së cilës është F.V. në të cilën ka qenë duke jetuar dhe i akuzuari, Policia e Kosovës kanë gjetur dhe sekuestruar substanca narkotike, dhe një peshore digjitale.

Gjykata, faktet e sipër cekura, i ka vërtetuar pjesërisht edhe nga vet mbrojtja e të akuzuarit F.V. i cili gjatë shqyrtimit gjyqësor është mbrojtur në heshtje, mirëpo i njëjti në fazat e më hershme, përkatësisht gjatë deklaramit të tij në Polici kishte deklaruar se është përdorues i marihuanës dhe se substancën narkotike e ka poseduar për konsumim personal. Ndërsa, sa i përket peshores i njëjti kishte deklaruar se i përkasin atij, por që nëna e tij nga frika i ka parë dhe i ka marrë të njëjtat.

Gjykata nuk ia fali besimin deklaratës së tij, pasi që siç u theksua edhe më lart, është vërtetuar fakti se i akuzuari ka qenë në posedim dhe në kontroll të sasisë së narkotikëve që janë objekt i akuzës kundër tij dhe se të gjitha rrethanat e rastit të cilat u sqaruan edhe më lart, tregojnë se i njëjti kishte për qëllim që narkotikun në fjalë, të shesë. Ky fakt vërtetohet përmes provave që



janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor siç janë raportet e policisë, ekspertiza mbi ekzaminimin e narkotikëve, lista e gjërave të konfiskuara (narkotikëve).

Të gjitha provat materiale vërtetojnë faktin se i akuzuari sasinë e narkotikëve të cilën e mbante në lokalin dhe shtëpinë e tij, e kishte fshehur dhe kishte për qëllim që ta shiste, këtë e dëshmon vet mënyra e paketimit në sasi të vogla, pastaj peshorja që shërben pikërisht për matjen e narkotikëve, e që kjo tregon se inkorporohen elementet e veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 paragrafi 1 të KPRK-së.

Gjykata, pas administrimit të provave, e ka ndryshuar përshkrimin e gjendjes faktike për të akuzuarin F., në raport gjendjen faktike të vërtetuar. Gjendja faktike është ndryshuar pas administrimit të të gjitha provave. Në këtë kontekst, përshkrimi i gjendjes faktike është ndryshuar vetëm në raport me sasinë e narkotikut të gjendur te i pandehuri pasi që në aktakuzën e dorëzuar nga prokuroria, përshkrimi i sasisë së narkotikut ishte bërë duke u bazuar në listën e gjërave të konfiskuara nga i pandehuri, listë kjo e datës 01.08.2019, ndërsa që gjykata, përshkrimin e sasive të narkotikut të konfiskuara nga i pandehuri, e ka bërë duke u bazuar në raportin e ekspertizës së Agjencisë së Kosovës për Forenzikë-AKF me numër Referues AKF-2019-2352/2019-2081 i datës 02.10.2019 i cili raport ka përcaktuar edhe peshën neto për secilën sasi të narkotikut të gjendur te i pandehuri. Gjykata, në përshkrimin e gjendjes faktike nuk ka ndryshuar identitetin subjektiv të veprës penale, nuk ka ndryshuar përmbajtjen esenciale lidhur me kohën, vendin, të pandehurin, mënyrën e kryerjes së veprës penale, përveç se ka ndryshuar, siç u theksua më lart, sasinë e narkotikut të gjendur te i pandehuri. Andaj, gjykata e ka përshkruar gjendjen faktike ashtu siç është vërtetuar me provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor.

*Matja e llojit dhe lartësisë së dënimit:*

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, Gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë me rastin e shqiptimit të dënimit konform nenit 69 dhe 70 të KPRK-së. Si rrethana rënduese, gjykata gjeti rrezikshmërinë shoqërore të kësaj vepre penale në kontekst të saj se ky lloj i veprave penale, është gjithnjë e në rritje në vendin tonë si dhe shkallën e lartë të dashjes për kryerjen e kësaj vepre penale, ndërsa si rrethana lehtësuese, gjykata vlerësoi sjelljen korrekte të pandehurit në gjykatë, sasinë relativisht të vogël të narkotikut të cilën i pandehuri e posedonte me qëllim shitjen e tij, kohën e kaluar nga kryerja e veprës penale pasi që tashmë kanë kaluar afërsisht gjashtë vite, faktin se nga Regjistri Qendror i Evidencës Penale, rezulton se i pandehuri

më parë ishte i pagjykuar dhe gjithashtu edhe rrethanat personale e familjare pasi që i pandehuri është i martuar dhe baba i dy fëmijëve.

Gjykata, duke marrë për bazë rrethanat lehtësuese të cekura si më lartë, vendosi që ndaj të akuzuarit të shqiptojë dënimin me burgim nën minimumin e paraparë ligjore për veprën penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor, duke u bazuar në dispozitën ligjore nga neni 71 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 lidhur me nenin 72, paragrafi 1, nën paragrafi 1.4 të KPRK-së, në të cilën përcaktohet se :*“nëse për veprën penale është paraparë si masë më e ulët dënimi me burgim prej dy (2) vjet, dënimi mund të zbutet deri në gjashtë (6) muaj burgim”*.

Sipas bindjes së gjykatës, dënimi me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti si dhe dënimi me gjobë në shumën prej tetëqind (800.00) euro ndaj të akuzuarit, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të tij. Sa i përket dënimit me gjobë në këtë rast për të akuzuarin. Gjykata përveç rrethanave të cekura, ka vlerësuar dhe ka marrë parasysh edhe kushtet dhe mundësitë materiale për pagimin e gjobës, duke vlerësuar se dënimi me gjobë i shqiptuar për këtë të pandehur është i përballueshëm për kushtet ekonomike, për çka i ka lënë afatin e pagesës si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Gjykata të akuzuarit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke vlerësuar se dënimi i shqiptuar është në përputhshmëri me shkallën e përgjegjësisë dhe të rrezikshmërisë shoqërore për veprën penale me të cilën akuzohet i akuzuari dhe se Gjykata ka vlerësuar se me një dënim të tillë do të arrihet qëllim i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, se i akuzuari në të ardhmen do të përmbahet nga veprimet e paligjshme dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, pasi që njëra nga qëllimet e dënimit është të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, në parandalimin e personave të tjerë në kryerjen e veprave penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

#### *Konfiskimi:*

Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij Aktgjykimi duke u bazuar në dispozitën ligjore të nenit 267 paragrafi 5 të KPRK-së lidhur me nenin 276 paragrafi 1 dhe 2 nën paragrafi 2.4 të KPP-së ashtu që, ka urdhëruar konfiskimin e përhershëm të substancës narkotike-të llojit Kanabis (Marihuanë), e cila përmban Tetrahidrokanabinol (THC), me peshë neto të

përgjithshme: 6.28 gram, për të cilat ka urdhëruar Policinë e Kosovës që pasi ky aktgjykim të marr formën e prerë, të bëjë asgjësimin e kësaj substance narkotike.

*Vendimi për shpenzimet e procedurës penale:*

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449, 450 dhe 452 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e paushallit Gjyqësor, ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 36 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 të Ligjit nr.08\L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

*Kërkesa pasurore juridike:*

Sa i përket kërkesës pasurore-juridike, Gjykata nuk ka vendosur sepse në aktakuzë, nuk kishte të propozuar palë të dëmtuar.

Nga ajo që u tha më lartë, e në bazë të nenit 267, 359, 360, 364, 449, 450 dhe 452 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**

Departamenti për Krime të Rënda

PKR.nr.389/2020, datë 11.02.2025

Zyrtarja ligjore  
Doruntina BEKA

Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari  
Xhemajl JUSUFI

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimin të Aktgjykimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palët.